



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMUNA E PODUJEVËS  
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT  
18.03.2026

Duke u bazuar në nenin 62 par 3, të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 64.4, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 dt 29.06.2018, nenet 5, 27 dhe 28 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve, me nr. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, DKRS publikon:

### THIRRJE PUBLIKE

**Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve individuale, për organizimin e aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës.**

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Podujevës, u bën thirrje individëve, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e organizimeve rinore, sportive, kulturore dhe artistike, duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Komunën e Podujevës.
2. Individët në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt/propozimet për organizimin e aktiviteteve rinore, sportive, kulturore dhe artistike.
3. Individët mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon në aktivitetet rinore, sportive dhe jetën kulturore, përmes aktiviteteve si më poshtë:
  - a) artin pamor (ekspozita);
  - b) art në hapësira publike (murale);
  - c) botim dhe promovim i librit;
  - d) festival kulturor dhe artistik për shënimin e datave të rëndësishme në Komunën e Podujevës;
  - e) organizimin e aktiviteteve sportive për shënimin e datave të rëndësishme në Komunën e Podujevës;
  - f) mbrojtjen, ruajtjen dhe avancimin e trashëgimisë kulturore, arkeologjike dhe arkitekture;
  - g) aktivitete të tjera kulturore, rinore, sportive dhe artistike.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes për subvencione për krijimtari individuale është 20,000 € (euro). Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 300 € (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është 3,000 € (euro).
5. Individët mund të aplikojnë vetëm me një projekt.
6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë.
7. Periudha e zbatimit të projektit është nga nënshkrimi i kontratës deri më 30.12.2026.
8. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, nga data 18.03.2026 dhe përfundon me datën 10.04.2026 në ora 16:00.

### **Cilat janë objektivat e thirrjes?**

- a) Hartimi, planifikimi dhe zbatimi i programeve/projekteve apo aktiviteteve rinore nëpërmjet të cilave identifikohen dhe adresohen kërkesat e të rinjve dhe promovohet zhvillimi i rinisë.
- b) Hartimi, planifikimi dhe zbatimi i programeve/projekteve apo aktiviteteve kulturore nëpërmjet të cilave promovohet zhvillimi i jetës kulturore.
- c) Hartimi, planifikimi dhe zbatimi i programeve/projekteve apo aktiviteteve sportive nëpërmjet të cilave promovohet zhvillimi i sportit.
- d) Zhvillimi dhe promovimi i edukimit joformal nëpërmjet të cilave mëtohet zgjerimi i shkathtësive së të rinjve.
- e) Fuqizimi i vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.
- f) Organizimi i festivaleve kulturore dhe ekspozitave artistike.
- g) Përfshirja e individëve në krijimin, masivizimin, rritjen e cilësisë, zgjerimin/shtrirjen e ngjarjeve/aktiviteteve/ kulturore, rinore, sportive dhe artistike;
- h) Krijimi i ngjarjeve/aktiviteteve rinore, kulturore, sportive dhe artistike nëpërmjet partneritetit me individët në fushat e kulturës, rinisë, sportit dhe arteve;
- i) Përfshirja e ideve dhe potencialit të individëve në funksion të ringjalljes së jetës kulturore dhe artistike;
- j) Rritja e cilësisë së krijimtarive në kulturë dhe arte, nëpërmjet mbështetjes së ideve, propozimeve dhe ngjarjeve/aktiviteteve;
- k) Shtrirja dhe zgjerimi i ngjarjeve/aktiviteteve në zona rurale;
- l) Përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes në ngjarje/aktivitete të grupeve të marginalizuara.

### **Cilat janë kriteret e përgjithshme?**

- a) projektet duhet të zbatohen në Komunën e Podujevës;
- b) projektet dhe individët aplikues mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Podujevës;
- c) individët të cilët nuk e kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Podujevës në këtë thirrje dhe nuk mund të përzgjidhen përfitues;
- d) projektet duhet të reflektojnë nevojat dhe objektivat e Komunës së Podujevës për këto fusha:

Të mos ekzistojë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;

Individët nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Podujevës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme, si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Podujevës;

Individët duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat e cekura më lartë; dhe

Të dëshmoj kompetencë profesionale për zbatimin e projektit.

### **Cilat janë kriteret e veçanta?**

1. Art pamor:
  - a) portfolio e artistit/es;
  - b) Listë e punimeve që prezantohen;
  - c) Koncept vizual i veprës.
2. Art në hapësira publike:
  - a) portfolio e artistit/es;
  - b) Listë e punimeve që prezantohen;
  - c) Koncept vizual i veprës;
  - d) Të kërkohet leje nga drejtoria përkatëse komunale para aplikimit.
3. Botime librash:
  - a) Biografi e autorit/es;
  - b) Recencion i veprës;
  - c) Një pjesë e veprës që do të botohet;
  - d) Prezantim i ilustrimeve (nëse ka);
  - e) Marrëveshje me shtëpinë botuese (nëse ka).

4. Festival kulturor dhe artistik për shënimin e datave të rëndësishme në Komunën e Podujevës:
  - a) Biografia e artistit/grupit apo organizatorit;
  - b) Lista e performancave;
  - c) Përshkrimi i konceptit të koncertit;
  - d) Partnerë ose bashkëpunues (nëse ka).
  
5. Organizimin e aktiviteteve sportive për shënimin e datave të rëndësishme në Komunën e Podujevës:
  - a) Biografia e organizatorit;
  - b) Lloji i sportit dhe forma e turneut;
  - c) Plani organizativ dhe logjistik;
  - d) Partnerë ose bashkëpunues (nëse ka).

Në projekte të tjera kulturore, të ofrohen dëshmi të ngjashme me ato të sipërpërmendurat.

#### **Cilat dokumente duhet dorëzuar?**

- a) Vërtetimi/konfirmimi i llogarisë bankare të individit me afat gjatë datës së aplikimit. **Vëmendje: jo kopje e kartelës bankare.**
- b) Kopjen e letërnjoftimit;
- c) Deklarata për financimin e dyfishtë; (nëse ka)
- d) Formulari i projekt-propozimit të thirrjes publike;
- e) Formulari i propozim-buxhetit.
- f) Krahas kësaj liste, varësisht nga fusha artistike dhe sportive, shtohen dokumentet e kërkuara tek kriteret e veçanta.

Dokumentet e kompletuara duhet të vendosen në zarf dhe të dorëzohen në: Ndërtesa e Komunës së Podujevës, Rr. Nuhi Gashi, në Zyrën për Shërbim të Qytetarëve. Në zarf duhet të shkruhet: *Aplikim në kuadër të Thirrjes për Projekt-Propozime për vitin 2026.*

#### **Vëmendje:**

- a) Aplikacionet të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen.
- b) Dokumentet e dorëzuar pas përfundimit të afatit në kuadër të thirrjes publike nuk do të pranohen;
- c) Ngarkimi i gabuar i dokumentacionit ose dokumentacioni i skanuar jo në formën e duhur, rrjedhimisht me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit.
- d) Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. Kjo vlen edhe për ndryshim të xhirlogarisë.

- e) Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t' i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.
- f) Nuk do merren në shqyrtim individët, të cilët nuk janë treguar të përgjegjshëm në deklarin dhe formën e mbajtjes së aktivitetit në vitet paraprake.
- g) Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

### **Hapat që duhet ndjekur pas realizimit të projektit/programit apo aktivitetit:**

Pas përzgjedhjes dhe realizimit të projektit, përfituesi është i/e obliguar që të dorëzojë brenda afatit kohor raportin narrativ dhe raportin financiar. Raportet duhet të përgatiten në mënyrë elektronike.

- a) raporti narrativ - përfshin dëshmi nga projekti i aktivitetit, siç janë fotografitë apo listat e pjesëmarrësve. Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga përfituesi dhe të dorëzohet pas përfundimit të projektit.
- b) Raporti financiar - kërkohet që të përmbushen obligimet e raportit financiar njëjtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Në raportin financiar duhet të përshkruhen shpenzimet në përputhje me buxhetin origjinal duke reflektuar shpenzimet e kërkuara dhe ato të kryera, si dhe të evidentoj çdo fond të pashpenzuar (të cilat duhet të kthehen ose për të cilat kërkohet shtyrje e afatit të përdorimit). Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga përfituesi dhe të dorëzohet pas përfundimit të projektit.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport do të vazhdoj procedurat e realizimit të thirrjes publike në përputhje me normat dhe rregullat ligjore.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [jakup.gashi@rks-gov.net](mailto:jakup.gashi@rks-gov.net) dhe [omer.kosumi@rks-gov.net](mailto:omer.kosumi@rks-gov.net) ose në hapësirat e DKRS në objektin e Komunës.

Drejtoreshë  
Për Kulturë, Rini dhe Sport  
Valbona Ibishi Azemi

